



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



Në bazë të nenit 11, parag. 1, nenit 18, parag.1 dhe 3, nenit 20, parag. 1 të Ligjit nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 11, parag. 1, pika 1 të Vendimit për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës komunale, nenit 5, parag. 1, shkronja e dhe nenit 66, parag. 66.2 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, nenit 4 dhe nenit 59, parag.59.6 të Statutit të Komunës së Prishtinës, të datës 25.2.2010, Udhëheqësi i Personelit të Shërbimit Civil Komunal, publikon këtë:

K O N K U R S

PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

POZITA : Përfaqësues juridik i Komunës

KOEFICIENTI: 10

LLOJI I POZITËS : i karrierës

POZITA FUNKSIONALE: nëpunës civil i nivelit drejtues

ORARI I PUNËS: 40 orë në javë

PËRGJEGJËSIA MBIKËQYRËSE: po

MBIKËQYRJA: Kryetari i Komunës.

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS:

- Udhëheq dhe koordinon punët në Zyrën e përfaqësimeve juridike të Komunës;
- Përfaqëson dhe mbron interesin e Komunës, e të institucioneve që financohen nga Komuna, në procedurën civile, penale, përmbaruese, dhe administrative, në gjykata të vendit në të gjitha nivelet;
- Ndërmerr të gjitha veprimet procedurale për mbrojtjen e interesit pasuror dhe juridik të Komunës, në përputhje me përgjegjësitë e tij të përcaktuara me ligj;
- Kryen edhe punë të tjera si përfaqësues juridik i Komunës nga rrethi i përgjegjësive që janë përcaktuar me ligj dhe me akte të brendshme të Komunës;
- Për punën e tij i raporton Kryetarit të Komunës.

Kushtet: Përgatitja superiore, Fakulteti Juridik, 3 vjet përvojë pune, provimi i dhënë i Jurisprudencës, njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme.

POZITA : Zëvendës përfaqësues juridik i Komunës – një (1) ekzekutues

KOEFICIENTI: 9

LLOJI I POZITËS : i karrierës

POZITA FUNKSIONALE: nëpunës civil i nivelit drejtues

ORARI I PUNËS: 40 orë në javë

PËRGJEGJËSIA MBIKËQYRËSE: po

MBIKËQYRJA: përfaqësuesit juridik dhe Kryetarit të Komunës.

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS:

- Ndhmon përfaqësuesin juridik të Komunës në përgatitjen dhe kompletimin e lëndëve, që janë në përgjegjësi të Zyrës së përfaqësimeve, gjatë të gjitha fazave procedurale administrative dhe gjyqësore;
- Merr pjesë në seanca gjyqësore, në cilësi të përfaqësuesit, ku e përfaqëson dhe e mbron Komunën dhe institucionet e financuara nga Komuna, sipas autorizimit të përfaqësuesit juridik të Komunës;
- Mbron interesat e Komunës, në pajtim me përgjegjësitë dhe funksionin e paraparë me ligj dhe rregulloren në fuqi;
- Kryen detyra dhe punë të tjera sipas urdhërit të përfaqësuesit juridik të Komunës dhe Kryetarit të Komunës, në pajtim me dispozitat që kanë të bëjnë me përfaqësimin.

KUSHTET : Përgatitja superiore, Fakulteti Juridik, 3 vjet përvojë në pune, provimi i dhënë i Jurisprudencës, njohja e punës me kompjuter është e obligueshme.

Data e shpalljes se Konkursit 27.03.2012

Të interesuarit që aplikojnë për këto vende të lira të punës, duhet t'i drejtohen Panelit intervistues.

Do të ftohen vetëm kandidatët, të cilët përfshihen në listën e ngushtë .

“ Shërbimi Civil i Komunës është në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe mirëpret aplikime nga meshkujt dhe femrat e të gjitha komuniteteve të Kosovës “.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes për postet e cekura më lart.

Fletë aplikacionet e kandidatëve me dokumente të pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit, nuk do të merren në shqyrtim si dhe dokumentacioni nuk kthehet.

VËREJTJE: Dokumentacioni (diploma dhe përvoja e punës)i bashkëngjitur aplikacionit duhet të jetë i fotokopjuar dhe i vërtetuar.

Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni në Zyrën e personelit, nr. 40, në këtë nr. të telefonit 038 / 230 – 900, lok . 10 –70.